



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 nr. 11-303
07.09.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3313/1 datë 31.8.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3375/2 datë 6.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të, mbajtur më 6.9.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim
për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA – SAT 2000 SHPKNJP Ohër, sepse ka ritransmetuar shërbim programor i cili nuk ishte i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).
Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3313/1 datë 31.8.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi me Shtojcë nr.1.
- URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA – SAT 2000 SHPKNJP Ohër, menjëherë pas marrjes së këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor.
- Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk veproi sipas aktvendimit respektivisht vazhdon me kryerjen e shkeljes për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.
- Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet (konsiderohet) dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë Ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose rregulloreve miratuar në bazë të Ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve për lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të këtij Ligji, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në kuadër të kompetencave Ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 29.8.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore ritransmetuar nga ana e operatorit Shoqërisë tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime ALTRA – SAT 2000 SHPKNJP Ohër, nga ku konstatoi se operatori në fjalë, i cili sipas njoftimit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territor e Komunës së Ohrit, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, i cila nuk përfshihet në çertifikatën për regjistrim të shërbimit programor të dhënë (lëshuar) nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të

specifikuara në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-3313/1 datë 31.8.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3313/1 datë 31.8.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3375/2 datë 6.9.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim që ndaj subjektit të lartpërmendur të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhëresës, respektivisht nëse pas paralajmërimit publik ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.11-3313/1 datë 31.8.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.